



- SALSTAT -

BULETIN INFORMATIV

STATISTIKA TË FORTA VENDORE SHQIPTARE

Përmbajtja:

Prill 2023 – Shtator 2023

Projekti “Statistika të Forta Vendore Shqiptare”, ose SALSTAT II, është pjesë e projektit “Bashki të Forta” të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) për një periudhë kohore Tetor 2022 – Shtator 2026. Projekti “Bashki të Forta” është përqendruar në disa aspekte të zhvillimeve vendore në Shqipëri, në mbështetje të decentralizimit dhe qeverisjes vendore.

Palët kyç të projektit janë INSTAT-i, bashkitë dhe disa ministri të linjës e agjenci qeveritare, në veçanti ato që kanë për detyrë të mbledhin të dhëna statistikore dhe/ose janë përgjegjëse për të dhënat/regjistrat administrativë.

Gjatë fazës së re, SALSTAT II do të intensifikojë bashkëpunimin me bashkitë dhe agjencitë e tjera qeveritare për të forcuar besimin te statistikat zyrtare, si dhe do të angazhohet në një diskutim me palët e interesit rreth përfitimeve që statistikat zyrtare sjellin për qeverisjen demokratike dhe procesin e vendimmarrjes, në veçanti për përmbushjen e detyrave, përgjegjësi dhe funksioneve të bashkive.

- Vepërtaria: “Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm” (SDGs) me fokus mbi Njohjen të Dhënave” Vizita e Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Federale të Statistikave të Zvicrës, në INSTAT
- Zhvillimi i një koncepti për Panelin Digjital (Dashboard)
- Regjistri Statistikor Shqiptar i Ndërtesave dhe Banesave
- Trajnim i personelit të Zyrave të Gjendjes Civile për përmirësimin e cilësisë së Statistikave Vitale
- Takim me Shoqatën Shqiptare për Autonomi Vendore (ALAA)
- Sinërgjia mes SALSTAT II dhe HELVETAS
- Sinërgjia me UN Women Albania
- Përgatitja e trajnimit për personelin e Bashkive mbi përdorimin e programit Excel.

Veprimtaria: “Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm” (SDGs) me fokus mbi Njohjen e të Dhënave”

Në 9 Maj, 2023, Instituti i Statistikave të Shqipërisë dhe Zyra Federale e Statistikave të Zvicrës (FSO), në bashkëpunim me Ambasadën e Zvicrës në Tiranë, organizuan veprimtarinë “SDG-të me fokus mbi Njohjen e të Dhënave” në ambientet e Hotel “Rogner”. Kjo veprimtari ishte pjesë e një iniciative për shfrytëzimin e potencialit të të dhënave, e iniciuar nga Konfederata Zvicerane dhe partnerët e vet, me synimin për të ngritur ndërgjegjësimin mbi zbatimin e SDG-ve në Shqipëri, me fokus mbi Njohjen e të Dhënave dhe shkëmbimin e përvojës mbi këto SDG me Zvicrën. INSTAT prezantoi botimin e librit “Arritjet e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Shqipërisë 2022”, mbështetur nga projekti SALSTAT II. Programi ishte si vijon:

Fjala e mirëseardhjes:

Znj. Elsa Dhuli – Drejtor i Përgjithshëm, Instituti i Statistikave të Shqipërisë
SH. e Saj, Znj. Ruth Huber – Ambasadore e Ambasadës së Zvicrës në Tiranë

Fjala kryesore:

Znj. Fiona McCluney – Koordinator i Përhershëm i OKB-së në Shqipëri

Prezantime:

“Përvoja zvicerane me zbatimin e SDG-ve” nga Dr. MBA Georges-Simon Ulrich – Drejtori i Përgjithshëm, Zyra Federale e Statistikave të Zvicrës;

“Rëndësia e statistikave zyrtare për SDG-të” nga Znj. Elsa Dhuli – Drejtor i Përgjithshëm, Instituti i Statistikave të Shqipërisë;

Panel i diskutimeve

Z. Ilir Beqaj – Drejtor i SASPAC

Znj. Anila Denaj – Kryetare e Nën-komitetit Parlamentar mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm

Z. Edvin Zhllima, Përfaqësuesi i EUD

Znj. Kozeta Sevrani, Përfaqësuese e Këshillit të Statistikave

Fjalët mbyllëse:

SH. e Saj, Znj. Ruth Huber – Ambasadore e Ambasadës së Zvicrës në Tiranë

Znj. Elsa Dhuli – Drejtor i Përgjithshëm, Instituti i Statistikave të Shqipërisë



Vizita e Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Federale të Statistikave të Zvicrës, në INSTAT

Më datën 9 Maj 2023, Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Federale të Statistikave të Zvicrës (FSO), Z. Georges-Simon Ulrich vizitoi INSTAT-in. Me këtë rast, u zhvillua një takim me Drejtorët e INSTAT-it dhe ekipin e projektit SALSTAT, me pjesëmarrjen e përfaqësueses së Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, Znj. Elda Bagaviki. Diskutimet kryesore ishin të lidhura me projektin SALSTAT II, mbi ecurinë e projektit dhe planet e ardhshme të zbatimit, përfshirë sfidat, si dhe lidhur me angazhimin e INSTAT dhe me punën mbi inovacionin dhe shkencën e të dhënave.

INSTAT përgatiti për FSO-në një material, si një përmbledhje me ndikimet dhe pasojat e SALSTAT mbi zhvillimin dhe modernizimin e Sistemit Statistikor Shqiptar.



Zhvillimi i një koncepti për Panelin Digjital (Dashboard)

Nga data 19 - 21 Qershor 2023, një ekip nga INSTAT-i, bëri një vizitë studimore në Zyrën Federale të Statistikave të Zvicrës (FSO), lidhur me shpërndarjen e statistikave dhe mjetet e komunikimit, si dhe planifikimin/monitorimin e projekteve.

Gjatë kësaj vizite, ekipi i INSTAT-it fitoi njohuri të ndryshme në fusha specifike dhe aspekte të ciklit të shpërndarjes dhe komunikimit të FSO-së, duke përfshirë aspekte të monitorimit dhe planifikimit.

Fokusi u vendos mbi botimin dhe shpërndarjen e rezultateve statistikore (publikimi dhe shpërndarja), si dhe te procesi i cilësisë, monitorimi dhe buxhetimi i projekteve, duke përfshirë instrumentet e rëndësishme të FSO-së.



Regjistri Statistikor Shqiptar i Ndërtesave dhe Banesave

Në kuadër të projektit SALSTAT II, INSTAT-i është duke hartuar Regjistrin Statistikor Shqiptar të Ndërtesave dhe Banesave (RSShNB).

Më datat 23 - 24 Maj 2023, u zhvillua në Tiranë seminari "Fillimi i Mandatit Teknologjisë Informacionit (TI) për Regjistrin Statistikor të Shqipërisë për Ndërtesat dhe Banesat".

Mandati ka të bëjë me aktivitetin e planifikuar nr. 2.2: "Një regjistër funksional statistikor për ndërtesat dhe banesat po hartohet" dhe është pjesë e aktivitetit 2.2.3: "Ngritja e infrastrukturës së TI dhe e strukturës përkatëse të lidhjes për transmetimin e të dhënave ndërmjet INSTAT dhe institucioneve përkatëse qeveritare".

Gjatë seminarit, INSTAT me një ekspert ndërkombëtar paraqiti gjendjen aktuale të punës që çon drejt zbatimit të RSShNB në Shqipëri. Qëllimi ishte që t'u jepej ekspertëve të TI një kuptim i përbashkët i gjendjes së tanishme. U paraqitën dhe u diskutuan temat e mëposhtme:

- Informim mbi gjendjen e zbatimit të RSShNB (prezantim i shkurtër dhe përmbledhje mbi punën e bërë deri më tani)
- Census 2023 – inventarizimi (paraqitje e shkurtër, duke përfshirë Projekt Pilotin e Census 2021)
- Mirëmbajtja e RSShNB pas Census 2023 (prezantim mbi burimin e të dhënave dhe mbledhjen e të dhënave, ndjekur nga diskutime të përgjithshme)
- Kuptimi i përgjithshëm i mandatit të TI-së: - Përshkrim dhe pyetje
- Elementet bazë (nivelet e aplikimit) për infrastrukturën e TI-së të RSShNB (prezantimi i hyrjes për zhvillimin e bazës së të dhënave, funksionalitetet e menaxhimit të të dhënave, dizajni i ndërfaqes së përdoruesit), e ndjekur nga diskutimi i përgjithshëm)

U prezantuan dhe u diskutuan temat e mëposhtme:

- Koncepti dhe struktura e kontrolleve të cilësisë (prezantim të dhënash në RSShNB - Sistemi i menaxhimit të cilësisë; pasuar nga diskutimi i përgjithshëm)
- Miratimi bazë i konceptit dhe strukturës së kërkuar të kontrolleve të cilësisë
- Dukuritë dhe funksionalitetet kryesore për përditësimin e të dhënave RSShNB (prezantimi i hyrjes në rastet e përdorimit të RSShNB; pasuar nga diskutimi i përgjithshëm)
- Miratimi bazë i prioritetëve dhe mënyra e specifikimit të funksioneve të kërkuara të përditësimit të RSShNB
- Planifikimi i përgjithshëm i rrymave të ndryshme të punës në TI me fokus në aktivitetet e vitit 2023 (integrimi në një plan pune).
- Organizimi i punës ekipore dhe shkëmbimi i dokumenteve (diskutim i përbashkët dhe takime në MS Teams). Formulimi i hapave të mëtejshëm (Kush bën çfarë deri kur).
- Përmbledhja dhe mbyllja e takimit.



Bazuar në planin e punës së ngritur, ekspertët ndërkombëtarë, INSTAT (GIS dhe ekipi TI) po zbatojnë aktivitetet deri në tremujorin e parë të 2024.

Trajnim i personelit të Zyrave të Gjendjes Civile për përmirësimin e cilësisë së Statistikave Vitale (treguesit demografikë)

Në kuadrin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit, të firmosur midis INSTAT dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC), në bashkëpunim të ngushtë me SALSTAT, u organizuan dy raunde trajnimesh për punonjësit e Zyrave të Gjendjes Civile (ZGJC) të Qarkut Durrës dhe Fier.

Trajnimi dy-ditor për ZGJC Durrës, u mbajt më 19 – 22 Qershor, 2023, në dy grupe, sipas ndarjes së bërë nga DPGJC.



Trajnimi për ZGJC Fier, u organizua më 25 – 28 Shtator, 2023, në tre grupe sipas ndarjes së bërë nga DPGJC.



Gjatë trajnimit dy-ditor, pjesëmarrësit përfituan një kuptim më të gjerë të synimeve të INSTAT dhe të DPGJC-së, të rëndësisë së saktësisë së statistikave vitale dhe regjistrit administrativ. Pjesëmarrësit ishin aktivë në diskutime, ndanë përvojën dhe propozuan zgjidhje për përmirësimin e cilësisë së të dhënave vitale. Sesioni i trajnimit u mbyll me një angazhim nga të gjithë pjesëmarrësit për zbatimin e njohurive të marra dhe të punës së përbashkët për nxitjen e procesit të regjistrimit dhe të cilësisë së të dhënave në Shqipëri.

Gjatë identifikimit të problemeve të regjistrimit të vdekjeve, INSTAT propozoi shpërndarjen e listës së kodeve të sëmundjeve dhe përshkrimin e sëmundjeve sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Sëmundjeve dhe të Problemeve të Shëndetit që lidhen me to (ICD 10) dhe shprehën idetë e tyre, si të regjistrohen kodet në sistemin e tanishëm të regjistrimit (NCSR).

Takim me Shoqatën për Autonomi Vendore të Shqipërisë (ALAA)

Gjatë muajit Korrik të 2023-shit, u zhvillua një takim me ekipin e projektit SALSTAT dhe Znj. Adelina Farrici, Drejtore e Përgjithshme e Shoqatës për Autonomi Vendore të Shqipërisë, si pjesë e Komitetit Drejtues të SALSTAT-it.

Në këtë takim, u diskutua mbi mundësinë e bashkëpunimit me stafin e bashkive dhe nevojat e tyre për trajnime. Një nga interesat kryesore të bashkive është të disponojnë të dhëna në nivel bashkie për t'i ndihmuar të kryejnë detyrat e tyre administrative.

Gjithashtu, nëse bashkitë disponojnë të dhëna më të hollësishme për bashkinë e tyre, kjo do të ndihmojë në drejtim të zhvillimit të tyre.

Sinergjia mes SALSTAT II dhe HELVETAS

Në kuadër të sinergjisë mes dy projekteve SALSTAT II dhe HELVETAS, mbahen takime të rregullta mujore me qëllim shmangien e mbivendosjes së aktiviteteve.

Një takim i përbashkët, me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve të SDC-së, u mbajt më 30 Gusht, 2023, me fokus bashkëpunimi i mëtejshëm mbi treguesit lidhur me statistikën mbi mbetjet urbane dhe arsimin parashkollor. Aty u ndanë edhe shumë ide mbi përmirësimin e punës së njësive të performancës në Bashki.



Sinergjia me UN Women Albania

Në kuadrin e sinergjive midis dy projekteve SALSTAT dhe UN Women Albania, u vendos një shkëmbim i rregullt midis 2 projekteve. Takimi i parë i radhës, u zhvillua në 19 Korrik, 2023, me znj. Erisa Çela, Menaxher Programi për Politikën me Bazë Gjinore, Planifikimi dhe Buxhetimi, UN Women Albania, dhe Zj. Majlinda Nesturi, Konsulente Kombëtare për statistikën mbi bazë gjinore, UN Women Albania, për të ndarë informacion mbi aktivitetet e përbashkëta dhe bashkëpunimin e mëtejshëm.



Gjatë takimit në 12 Shtator, 2023, janë diskutuar pikat e mëposhtme:

- Zhvillimi i një vizite të përbashkët në terren në bashkitë Fier, Delvinë dhe Pogradec, për të vlerësuar nevojat e tyre për ngritjen e kapaciteteve në lidhje me statistikën, dhe në veçanti statistikën gjinore.

- Planifikimi i një takimi teknik, midis projekteve të UN Women, SALSTAT, Helvetas, INSTAT, SDC dhe UNDP-LNB. Ky takim do të përqëndrohet mbi bisedat teknike mes partnerëve dhe është propozuar të zhvillohet në tremujorin e katërt të vitit 2023.

- Shpërndarja e një pyetësoi për pjesëmarrësit në trajnime, për të marrë mendimin e tyre në lidhje me nevojat e tyre specifike, përfshirë disa pyetje lidhur me barazinë gjinore, të përgatitura nga UN Women. Pyetësoi do t'u shpërndahet pjesëmarrësve nga të gjitha Bashkitë që marrin pjesë në trajnimin që do të zhvillohet në muajin Tetor 2023.

- Në trajnimin e ardhshëm të organizuar nga INSTAT/SALSTAT me stafin e bashkive, do të caktohet një gjysmë ditë trajnimi për modulën e tyre mbi çështjet e statistikave me bazë gjinore me ekspertin e UN Women.



Në 18-21 Shtator, 2023, u organizuan vizitat e përbashkëta në bashkitë e Fierit, Delvinës, dhe Pogradecit, me qëllim që të identifikoheshin mirë nevojat, kapacitetet e bashkive dhe të diskutoheshin hapa konkretë për bashkitë, sidomos lidhur me mbledhjen e të dhënave me bazë gjinore.

Bashkia e Delvinës



Bashkia e Fierit



Bashkia e Pogradecit



Përgatitja e trajnimit për personelin e Bashkive mbi përdorimin e programit Excel

Ekipi i SALSTAT-it ka organizuar takime në Bashkitë e Qarkut të Korçës dhe disa Bashki të Qarkut të Shkodrës, me praninë e ekspertit lokal për statistika dhe programit Excel.

Qëllimi i takimit ishte të forcohej bashkëpunimi mes INSTAT / SALSTAT dhe bashkive, për të promovuar dhe diskutuar aktivitetet që lidhen me Bashkitë si dhe për të përfshirë pjesëmarrësit në një shkëmbim për nevojat e bashkive gjatë fazës II të projektit SALSTAT, por edhe për të kuptuar më mirë cilat janë nevojat konkrete të stafit të Bashkive për përdorimin e programit Excel.

Gjatë takimeve u diskutuan çështjet e mëposhtme:

- Projektet SALSTAT, faza II, në kuadrin e mbështetjes së qeverisë së Zvicrës për INSTAT dhe përmirësimin e të dhënave vendore;
- Qëndrueshmëri e personelit të Bashkive, të trajnuar në kuadër të projektit SALSTAT II si dhe trajnime të tjera në vazhdim;
- Nevoja dhe kërkesa nga bashkitë (përfaqësues të bashkive);
- Pyetësor lidhur me detajet e programit Excel, çfarë ka më shumë nevojë personeli.


Rezultatet e arritura nga takimet:

- Kryetarët dhe Zv. Kryetarët e Bashkive që ishin të pranishëm gjatë takimeve, kërkuan që të mundësohet trajnimi i të gjithë stafit që mbledh të dhëna, punon me të dhënat dhe analizon të dhënat, pasi ka staf nga të gjitha departamentet që punojnë për të dhënë të dhëna personave përgjegjës që punojnë me statistika.
- Kryetarët kërkuan që personeli i tyre, të trajnohet mbi statistikat gjinore, mbi statistikat sociale, pasi ka nevojë dhe kërkesë për këto lloj të dhënash.
- Bashkitë shprehën gatishmërinë e tyre për Marrëveshjen e Bashkëpunimit me INSTAT-in. Ata janë në pritje të draftit nga ana e INSTAT, për të dhënë komentet e tyre dhe për të arritur një marrëveshje që do t'u mundësojë atyre jo vetëm dërgimin e të dhënave INSTAT-it, por edhe për të marrë statistikat dhe të dhënat nga INSTAT-i bazuar në nevojat e tyre.
- Bashkitë ishin mirënjohëse për mbështetjen e dhënë stafit të tyre në ngritjen e kapaciteteve me anë të trajnimeve dhe shprehën shqetësimin lidhur me dorëheqjen dhe largimin e tyre (orientimi i rregullt). Për këtë arsye, ata kërkuan një mbështetje të vazhdueshme me trajnime për stafin e tyre, veçanërisht ata që japin dhe përdorin të dhëna dhe statistika.

Bazuar në rezultatet, trajnimi i planifikuar për Excel-in do të ndryshohet në mënyrë që të përshtatet me nevojat ditore administrative të stafit të Bashkive. Trajnimet për stafin e Bashkive për përdorimin e programit Excel do të zhvillohen në datat 9 - 13 Tetor 2023, në mjediset e INSTAT-it.

6 – 8 shtator 2023: Qarku i Korçës:





14 – 15 shtator 2023: Qarku i Shkodrës



FALEMINDERIT NGA EKIPI I SALSTAT!

Menaxher i projektit:

Martin Teichgräber, Zyra Federale e Statistikave të Zvicrës

Koordinatorët:

Eralda Pushaj, Koordinatore për Njësitë Qendrore të Qeverisjes

Edlira Çeliku, Koordinatore për Çështjet Administrative dhe Financiare

Alketa Doçi, Koordinatore për të Dhënat dhe Regjistrat Administrativë